



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 48

Prishtinë, më 19 .10.2016, në ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Xhevahire Izmaqu, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Zenun Pajaziti, Agim Kikaj, Shqipe Pantina, Lahi Brahimaj dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Jelena Bontiq.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e: ZRPK-së, OSCE, KDI-së dhe KTV-së.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Xhevahire Izmaqu, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i mandateve të anëtarëve të bordeve, agjencive të cilat bien në fushëveprimtarinë e Komisionit;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i mandateve të anëtarëve të bordeve, agjencive të cilat bien në fushëveprimtarinë e Komisionit;

Xhevahire Izmaqu, e njoftoi Komisionin lidhur me pikën e rendit të ditës, për një shkresë anonime të një anëtari të Bordit të RTK-së, adresuar komisionit, e cila përmbante disa shkelje të

një anëtar i bordit, i cili në bazë të dispozitave në fuqi të ligjit për RTK-në, nuk ka ushtruar funksionin e anëtarit të bordit, duke munguar në takimet e bordit, dhe i cili nuk mund të vazhdojë të jetë më anëtar, për arsye se nuk ka respektuar ligjin sipas nenit 28.3 dhe nenit 29 të Ligjit për RTK-në.

Lidhur me këtë, Izmaku kërkoi mendimin e anëtarëve të komisionit, pasi që shkresa i ishte adresuar të gjithë anëtarëve të komisionit.

Shqipe Pantina, tha se është shqetësuese adresimi anonim i shkresës. Do të ishte më me arsye po të ishte adresuar si letër konfidenciale, por anonime është shqetësuese për dy arsye:

- Pse duhet dikush të dërgojë letër anonime nëse veç ka shkelje ligjore dhe e dyta vendimin për shkarkim e merr Bordi, ndërsa që ne nuk kemi një propozim vendim nga bordi, siç është e përcaktuar me ligjin në fuqi.

Pantina theksoi se duhet të kërkohet sqarim nga Bordi, pse ka ndodhur ky adresim anonim.

Zafir Berisha, tha se vet fakti që shkresës i janë bashkangjitur edhe procesverbalet për mungesën nga takimet e anëtarit të Bordit, nuk mund të thuhet se është shkresë anonime, sepse po duket që kjo është adresuar nga Bordi i RTK-së, por që kanë dashur të mbesin anonimë, ndërsa bashkëngjitja e procesverbaleve është dëshmi që komisioni të bindet se ka shkelje.

Sipas tij, shkresa jo që nuk duhet të shqyrtohet por edhe të kërkohet përgjegjësi nga bordi për qasje të gabuar ndaj komisionit.

Pasi veç është shtruar çështja si pikë e rendit të ditës, ai pyeti se a ka qenë kandidati i ftuar në takime të Bordit.

Meqë në kuadër të fushëveprimtarisë së komisionit bien edhe borde, komisione të tjera, ai propozoi të shqyrtohen edhe mandatet e anëtarëve të bordeve tjera dhe jo vetëm me raste individuale.

Berisha kërkoi, që në mbledhjen e radhës të ftohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të informuar komisionin për çështjet e sipërshënuara.

Sadri Ferati, duke kundërshtuar shqyrtimin e shkresës, ai propozoi të votohet kundër shqyrtimit të shkresës dhe heqjes nga rendi i ditës.

Lahi Brahimaj, tha se shkresat e tilla anonime adresohen në komision për të eliminuar persona të caktuar, që nga dita e parë kur personi, kundër të cilit është adresuar shkresa në komision, është emëruar anëtar i bordit të RTK-së nuk ka qenë lajm i mire për persona të caktuar në RTK. Ai njoftoi komisionin se ka informacione që personi në fjalë është thirr në takimet e bordit të RTK-së jashtë kushteve të përcaktuara të ftesës për takime. Sipas tij, është ofendim për deputetët të merren me shkresa anonime, sipas së cilave duhet të shkarkohen individë të caktuar.

Konstatim: anëtarët e Komisionit nga radhët e opozitës e kanë lëshuar mbledhjen për arsye të mospajtueshmërisë me rendin e ditës.

Zenun Pajaziti, tha se nuk është korrekte mënyra e sjelljes së anëtarëve të komisionit nga radhët e opozitës të lëshojnë mbledhjen, së paku duhet të qartësohemi dhe të dëgjojmë njëri-tjetrin. Duke mbështetur diskutimin e z. Sadri Ferati për mos shqyrtimin e shkresës, ai propozoi që të kërkohet një sqarim nga bordi për funksionimin e bordit, duke përfshirë edhe shkeljet. Kërkesa e

tij ishte që të kërkohet nga bordi që të prezantojë nëse ka shkelje dhe ato të bëhen publike, por jo duke i bërë çështjet selektive.

Xhevahire Izmaku, propozoi që të kërkohet nga Bordi i RTK-së, që shkresa të vulo

Sadri Ferati, nuk u pajtua me këtë propozim dhe propozoi që komisioni ta heq nga rendi i ditës dhe çështja në fjalë të mos jetë objekt diskutimi, dhe nëse vendoset ndryshe, atëherë edhe qasja e komisionit duhet të ndërrojë.

Agim Kikaj, tha se kjo është mënyrë e gabuar e komunikimit në mes institucioneve, në parim nuk duhet të ndodh.

3.Të ndryshme.

Xhevahire Izma

Mbledhja përfundoi në orën: 11:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Xhevahire Izma